

INSTITUTI PARLAMENTAR

Instituti Parlamentar (IP) është një drejtori e përgjithshme në administratën e Kuvendit që mbështet deputetët në ushtrimin e funksioneve të tyre përfaqësuese, ligjvënëse, dhe mbikëqyrëse. Byroja e Kuvendit themeloi IP si një shërbim më vete të administratës së Kuvendit, në 29 dhjetor 2020.

Puna e IP bazohet mbi parimet e objektitetit, paanësisë, koherencës, besueshmërisë, dhe transparencës. Instituti, ka si qëllim të mbështesë vendimmarrje të mirë-informuar përmes ofrimit të informacionit dhe produkteve kërkimore, si edhe zbatimit të një llojshmërie të programeve të edukimit qytetar. Instituti përbëhet nga tre shërbime:

- Shërbimi i Kërkimit dhe Analizës do i ofrojë deputetëve produkte kërkimore objektive, koherente, të besueshme, dhe në kohë, përfshirë këtu informacione, analiza, dhe studime.
- Shërbimi i Bibliotekës dhe Publikimeve do të mundësojë përdorimin efikas të librave, revistave dhe dokumenteve; do të ofrojë informacion për referencë ose që do përdoret nga deputetët, stafi i kuvendit, dhe qytetarët; Gjithashtu, ky shërbim do të përgatisë një sërë publikimesh lidhur me aktivitetin parlamentar.
- Shërbimi i Edukimit Qytetar do të krijojë dhe zbatojë programe të cilat informojnë dhe edukojnë qytetarët në lidhje me demokracinë dhe qeverisjen, si edhe do t'i nxisë qytetarët të jenë aktiv në punën e Kuvendit.

Krijimi i Institutit Parlamentar është bazuar në praktikat më të mira nga Shërbimi i Kërkimit në Kongresin e SHBA, në Shërbimin e Kërkimit në Parlamentin Europian, si edhe në Institutet Parlamentare të Republikës Çeke, Sllovakisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut.

Struktura e miratuar e stafit të IP përfshin drejtorin e përgjithshëm, drejtuesit e tre shërbimeve, shefat e katër sektorëve, dy këshilltarë, dhe 11 specialistë. Me mbështetjen e NDI, Kuvendi hartoi fushëveprimin e përgjegjësive të shërbimeve të PI, si edhe zhvilloi përshkrimet e punës së bashku me kualifikimet e nevojshme për secilin nga pozicionet. Drejtuesit e Kuvendit shprehën angazhimin e tyre për një proces rekrutimi bazuar në parimet e meritokracisë dhe paanësisë politike. NDI do të monitorojë nga afër të gjitha fazat e procesit, si edhe do të ofrojë një program orientimi, trajnimi, dhe mentorimi për stafin e rekrutuar.

Në mandatin e tij të ri, Kuvendi do të krijojë një Këshill Drejtues, të përbërë nga përfaqësues të gjitha grupeve parlamentare, i cili do të vëzhgojë punën e IP. Përfaqësues të NDI dhe SDC do të jenë pjesë e Këshillit Drejtues si vëzhgues. Një bord këshillimi i përbërë nga ekspertë lokal dhe ndërkombëtarë në fushën e kërkimit parlamentar dhe edukimit qytetar do të krijohet me mbështetjen e NDI, për t'ju ofruar drejtuesve të IP si edhe anëtarëve të Këshillit Drejtues këshillim dhe udhëzim strategjik.

IP është konceptuar si pjesë e Projektit Për Mbështetjen e Parlamentit dhe Edukimit Qytetar (PACEP), mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatuar nga Instituti Demokratik Amerikan.